



VENDIM

Nr. 131, Datë 15.08.2016

MBI

**“NDËRPRERJEN E PROCEDURËS SË SHPALLUR NGA SHOQËRIA
KESH SH.A “FTESË PËR SHPREHJE INTERESI PËR MARRËVESHJEN
KUADËR PËR DEPOZITIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.08.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, në lidhje me ndërprerjen e procedurës së shpallur nga shoqëria KESH sh.a “Ftesë për shprehje interesi Marrëveshjen Kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Në faqen zyrtare të KESH sh.a, është publikuar ftesa për shprehje interesi për “Marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”.
- Subjektet GEN-I Tirana sh.p.k, AXPO Trading AG dhe AAES kanë dërguar ankimet e tyre në ERE me shkresat respektive nr. 490/4 Prot., datë 08.07.2016; nr. 490/8 Prot., datë 26.07.2016 dhe nr. 13 Prot., datë 29.06.2016.
- KESH sh.a në datë 20.07.2016 nëpërmjet shkresës Nr. 5960/1 Prot.,i ka bërë me dije subjekteve si me sipër se : “Ky produkt i prezantuar nga KESH sh.a. nuk është subjekt i rregullimit nga Rregullat e shitjes, blerjes dhe shkëmbimit të energjisë elektrike të miratuar nga ERE. KESH sh.a. funksionon si një shoqëri tregëtare me kapital 100 % shtetëror bazuar në përcaktimet e ligjit “për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”.
- I licencuari KESH sh.a është një person juridik i pajisur me licencë në aktivitetin e Prodhimit të energjisë elektrike me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 23, datë 25.03.2009 i cili zbaton Legjislacionin në fuqi përfshirë dhe detyrimet e shërbimit publik të caktuara në përputhje me ligjin 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe ushtron aktivitet në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Është konstatuar se KESH sh.a. nuk ka respektuar dispozitat e Ligjit 43/2015 “Per sektorin e energjise elektrike” i cili parashikon si transaksione tw energjise elektyrike, blerjen, shitjen dhe shkembimin.
- KESH sh.a. nuk ka respektuar parashikimet e “Rregullave dhe procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr 100 datë 27.12.2006.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. KESH sh.a. të ndërpresë menjëherë çdo veprim të mëtejshëm për finalizimin procedurës së shpallur “Ftesë për shprehje interesi për Marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”.
2. KESH. Sh.a te publikojë ne faqen e tij zyrtare te internetit, njoftimin për ndërprerjen e procedurës ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a, Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.